

Njoftim i përqendrimit me të cilin Folksfagen Akciengezelshaft nga Gjermania do të fitoj kontroll të pavarur mbi Intenta GmbH nga Gjermania

(lënda nr. 08-75 nga viti 2022)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë "nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më datë 08.04.2022, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës dorëzohet një njoftim për përqendrim i cili i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga Folksfagen Akciengezelshaft me seli të regjistruar në Berliner Ring 2, 38440 Wolfsburg, Gjermani në mënyrë indirekte përmes shoqërisë së saj tërësisht në pronësi të KARIAD SE me seli të regjistruar në Berliner Ring 2, 38440 Wolfsburg, Gjermani mbi Intenta GmbH me seli të regjistruar në Ahornshtrase 55, 09112 Çemnic, Gjermani.

Folksfagen Akciengezelshaft është shoqëria mëmë (udhëheqëse) e Grupit Folksfagen.

Grupi Folksfagen është aktiv në mbarë botën në zhvillimin, prodhimin, marketingun dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta komerciale, kamionëve, autobusëve, autobusëve të transportit, autobusëve dhe shasi për autobusë dhe motorë me naftë, motoçikletave, duke përfshirë pjesë rezervë dhe pajisje shtesë. Grupi FV merret gjithashtu edhe me shpërndarjen e automjeteve. Grupi FV përfshin markat e automjeteve Folksfagen Pesinxher Kars, Folksfagen Lajtt Komrshal, Porshe, Audi, Shkoda, Bentli, Lamborgini, SEAT, MAN, Skania dhe Dukati. Grupi FV ofron gjithashtu shërbime celulare si automjetet në thirrje dhe ndarjen e automjeteve.

Përveç kësaj, Grupi Folksvagen ofron shërbime financiare dhe sigurimesh lidhur me shpërndarjen dhe financimin e makinave dhe automjeteve komerciale të tij, por gjithashtu mbulon aktivitete të rregullta bankare dhe të tjera sigurimesh.

Blerësi i drejtpërdrejtë, KARIAD SE, është një shoqëri e varur në pronësi të plotë të Folksfagen Akciengezelshaft dhe merret me zhvillimin e brendshëm të zgjidhjeve softuerike dhe aplikacioneve për makina për automjete të Grupit FV dhe më gjerë.

Grupi Folksfagen është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërive të varura të mëposhtme:

- Porshe Lizing SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup,
- Porshe Broker SHA Shkup, me seli në Bul. Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup,
- Skania Makedonia SHPKNJP Ilinden, me seli në adresën rr. 34 nr. 7 Ilinden, Shkup dhe
- Porshe Makedonia SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup.

Intenta GmbH zhvillon dhe integron, ndërmjet zgjidhjeve të tjera softuerike dhe softuer specifik i cili është një komponent i sistemeve (të avancuara) për ndihmën e shoferit dhe komponentëve të navigimit që ndihmojnë shoferin përmes përdorimit të sensorëve dhe algoritmeve. Konkretisht, Intenta është aktive në zhvillimin dhe integrimin e zgjidhjeve inteligjente softuerike që lidhen me përpunimin dhe analizën e të dhënave të marra nga sensorët, bashkimin e të dhënave nga sensorët dhe njohjen dhe zbulimin e objekteve/personave përmes zhvillimit të algoritmeve. Intenta nuk është aktive dhe nuk realizon të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

14.04.2022

Shkup